VENDIM
Nr. 280, datë 16.12.2024

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019, "MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA 'ALBGAZ' SHA PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 13, pika 1, 16, pika 2, 17, germa "e" dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe të neneve 15 dhe 21, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2542 prot., datë 13.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror "Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, 'Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sh.a. për vitin 2025"',

konstatoi se:

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 118 prot., datë 11.11.2024 (protokolluar me tonën nr. 223/6 prot., datë 12.11.202), ka informuar se rrethanat në të cilat ajo zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST) të gazit natyror nuk kanë pësuar ndryshime të rëndësishme që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në elementet përcaktuese të metodologjisë së tarifës. Për këtë arsye, shoqëria ka kërkuar që për vitin 2025 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit, e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 367, datë 15.12.2023.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 367, datë 15.12.2023, vendosi: shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a. sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- Neni 17, germa "e", e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", e ndryshuar, parashikon se: ERE, mund të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rast kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.
- Duke pasur parasysh se Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 23.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria "Albagaz" sh.a., i cili përfshin investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të shoqërisë, si dhe vlerësohet se deri në momentin e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë për miratimin e një tarife transmetimi të gazit natyror, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, bëhet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike e vendimit të B ordit të ERE-s nr. 206 datë 16.12.2019.
- Për arsye se tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë "Albgaz" sh.a., në përputhje me ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s për vitin 2025, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë "Albgaz" sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika "e", të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.
3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim

mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti